www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 150

Tiranë – E mërkurë, 19 gusht 2015

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 85/2015 datë 23.7.2015	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh. a. (Agjencia Zbatuese e Projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për shumën 20 milionë euro, për programin "Energji ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit".....	11033

LIGJ
Nr. 85/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (HUAMARRËSI), DHE KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE, SH. A. (AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT), DHE KFW FRANKFURT AM MAIN (KFW) PËR SHUMËN 20 MILIONË EURO, PËR PROGRAMIN "ENERGJI UJORE DHE SIGURIA E DIGAVE NË KASKADËN E DRINIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (huamarrësi) dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, sh. a. (agjencia zbatuese e projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për shumën 20 milionë euro, për programin "Energji ujore dhe siguria e digave në kaskadën e Drinit", sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2015

Shpallur me dekretin nr. 9197, datë 30.7.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE HUAJE
E DATËS _____
NDËRMJET KfW-së, FRANKFURT AM MAIN (KfW) DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (HUAMARRËSI) DHE KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE SHA (KESH) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) PËR SHUMËN 20,000,000.00 EURO PËR "ENERGJI UJORE DHE SIGURIA E DIGAVE NË KASKADËN E DRINIT"
BMZ-NR. 2009 66 531
HUAJA NR. 26946

PREAMBULË

Baza për këtë Marrëveshje është marrëveshja e datës _____ ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (FC) (Marrëveshja Qeveritare).

KfW-ja do të rifinancojë Huan e dhënë në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje me subvencione interesi nga fonde buxhetore me interes të ulët, të dhëna nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që mbushin kritere të pranueshmërisë së politikave të zhvillimit. Termat dhe kushtet e Huas përputhen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të Marrëveshjes për njohje si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

Mbi bazën dhe me kushtin që Republika Federale e Gjermanisë të ofrojë një garanci për Huan, KfW-ja do të japë një Hua në pajtim me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje:

1. Huaja

1.1 Shuma. KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një Hua që nuk kalon shumën totale prej

20,000,000.00 eurosh (Huaja).

Qëllimi. Huamarrësi do të kanalizojë Huan tërësisht tek Agjencia e Zbatimit të Projektit në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2 të saj. Agjencia e Zbatimit të Projektit do të përdorë Huanë ekskluzivisht, për:

a) rehabilitimin e portave të shkarkimit të hidrocentralit të Vaut të Dejës;

b) realizimin e një Qendre për Monitorimin e Digave dhe Informim; dhe

c) shërbimet e Konsulencës.

(Programi) që është pjesë e "Projektit të përgjithshëm të Sigurisë së Digave". Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë e Programit dhe furnizimet, mallrat, punët dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja me anë të një marrëveshjeje të veçantë (Marrëveshja e Veçantë).

1.2 Taksat, detyrimet, tatimet doganore. Taksat dhe detyrimet e tjera publike, që lindin nga Huamarrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit, si dhe tatimet doganore nuk do të financohen nga Huaja.

2. Kanalizimi i Huas

2.1 Huamarrësi e kanalizon Huan tek Agjencia e Zbatimit të Projektit sipas një marrëveshjeje të veçantë nënhuadhënieje në bazë të termave dhe kushteve përkatës të huadhënies, të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2.2 Para disbursimit të parë të Huas, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të vërtetuar të marrëveshjes së nënhuadhënies, të specifikuar në nenin 2.1.

2.3 Kanalizimi i Huas nuk përbën detyrim të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

3. Disbursimi

3.1 Kërkesat për disbursime. Pas përmbushjes së të gjitha kushteve pararendëse të disbursimit në bazë të neneve 2.2 dhe 3.3 të kësaj Marrëveshjeje, KfW-ja do të disbursojë Huan në pajtim me progresin e Programit dhe me kërkesë të Agjencisë së Zbatimit të Projektit. Disbursimet do të kryhen në përputhje me grafikun e disbursimit, në përmbajtje të shtojcës 1 të kësaj Marrëveshjeje. KfW-ja do të kryejë disbursimin vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtëmujor. Në masën që Agjencia e Zbatimit të Projektit kërkon disbursime të shumave më të ulëta brenda çdo gjashtëmujori, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në ndonjë prej periudhave të tjera të ardhshme gjashtëmujore. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të kryejë disbursime prej më pak se 200,000.00 eurosh.

3.2 Afati për kërkimin e disbursimeve. KfW-ja ka të drejtë të refuzojë kryerjen e disbursimeve pas datës 30 dhjetor 2018.

3.3 Kushtet pararendëse të disbursimit. KfW-ja është e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje vetëm nëse kushtet e mëposhtme pararendëse janë përmbushur në një mënyrë të pranueshme për KfW-në në formë dhe në përmbajtje.

a) Huamarrësi do të ketë demonstruar, në pajtim me kërkesat e KfW-së, me anë të paraqitjes së një opinioni ligjor, përmbajtja e të cilit është kryesisht sipas modelit në shtojcën 2 të saj dhe kopjeve të vërtetuara (secila me një përkthim zyrtar në gjuhën e kësaj Marrëveshjeje) të dokumenteve, të cilave i referohet ky opinion ligjor, se Marrëveshja e Huas është ligjërisht në fuqi dhe e zbatueshme dhe në veçanti, se:

i) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas së drejtës së vet kushtetuese dhe dispozitave të tjera të zbatueshme ligjore për marrjen përsipër në mënyrë të vlefshme të të gjitha detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

ii) KfW-ja përjashtohet nga të gjitha taksat mbi të ardhurat nga fitimet prej interesave dhe të gjitha detyrimet, komisionet dhe kosto të ngjashme në Shqipëri gjatë dhënies së Huas;

b) palët zotërojnë një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje, të nënshkruar me fuqi ligjërisht detyruese;

c) modelet e nënshkrimeve, të përmendura në nenin 13.1 të saj, janë marrë nga KfW-ja;

d) Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë, e përmendur në nenin 8, është në fuqi dhe efekt pa asnjë kufizim;

e) Huamarrësi ka paguar tarifën e menaxhimit, të përcaktuar në nenin 4.2 të kësaj Marrëveshjeje;

f) Nuk ka ndodhur asnjë arsye për përfundimin e Marrëveshjes, as ndonjë incident që do të bëhej shkak për përfundim/zgjidhje nga njoftimi ose skadimi, ose konstatimi ose përmbushja e një kushti (shkak i mundshëm për përfundimin/zgjidhjen e Marrëveshjes); dhe

g) nuk kanë lindur rrethana të jashtë-zakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Programit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje.

KfW-ja ka të drejtën, para ndonjë disbursimi nga Huaja, të kërkojë ato dokumente dhe prova të mëtejshme që i çmon të nevojshme sipas diskrecionit të vet për të konstatuar kushtet pararendëse për disbursimin e specifikuar në këtë seksion.

3.4 Hollësitë dhe procedura e disbursimit. Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë dhe procedurën e disbursimit nga Marrëveshja e Veçantë dhe, në veçanti, provat që duhet të jepen nga Agjencia e Zbatimit të Projektit që dokumentojnë se shumat e kërkuara të Huasë janë duke u përdorur për qëllimin e rënë dakord.

3.5 E drejta për anulimin e disbursimeve. Në bazë të përmbushjes së detyrimeve të tij, sipas nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të Huas me marrëveshje të ndërsjellë të të gjitha palëve të kësaj Marrëveshjeje kundrejt pagimit të një Kompensimi Mospranimi sipas dhe siç përcaktohet në nenin 3.6 të kësaj Marrëveshjeje.

3.6 Kompensimi i Mospranimit. Nëse Huamarrësi anulon disbursimin e një shume Huaje në bazë të nenit 3.5 të kësaj Marrëveshjeje ose nëse kjo shumë Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 3.2 të kësaj Marrëveshjeje, për arsye të tjera, për të cilat KfW-ja nuk mund të konsiderohet përgjegjëse, Huamarrësi do t'i paguajë menjëherë KfW-së, sipas kërkesës së saj, atë shumë që është e nevojshme për kompensimin e KfW-së për çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar nga KfW-ja si rezultat i mospranimit të shumës së anuluar të Huas (Kompensimi i Mospranimit). KfW-ja do të llogaritë shumën e Kompensimit të Mospranimit dhe do t'ia komunikojë Huamarrësit.

4. Tarifat

4.1 Tarifa e Angazhimit Financiar. Huamarrësi do të paguajë një tarifë të pakthyeshme angazhimi financiar prej 0.25% në vit (Tarifa e Angazhimit Financiar) për shumat e padisbursuara të Huas.

Tarifa e Angazhimit Financiar është e kërkueshme për pagesë çdo gjashtë muaj në shuma të prapambetura në datën 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, për herë të parë në datën 30 qershor 2015, por jo më herët se në datën përkatëse pas datës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe, efekt në bazë të nenit 14.10 të saj.

Tarifa e Angazhimit Financiar do të faturohet nëse është e zbatueshme me efekt prapaveprues për periudhën që fillon tre muaj pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi dhe efekt dhe që zgjat deri në datën e disbursimit të plotë të Huas ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e përfundimit të disbursimeve nga Huaja.

4.2 Tarifa e Menaxhimit. Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së një tarifë menaxhimi me një shumë të vetme të plotë të pakthyeshme prej 1% të shumës së Huas, të përcaktuar në nenin 1.1 të kësaj Marrëveshjeje (Tarifa e Menaxhimit).

Tarifa e Menaxhimit është e pagueshme në datën më të hershme nga dy datat e mëposhtme: i) para disbursimit të parë; ose ii) pasi të kenë kaluar tre muaj që prej nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW-ja ose pasi të ketë kaluar një muaj që prej hyrjes në fuqi dhe efekt të kësaj Marrëveshjeje (cilado nga datat e përcaktuara sipas pikës; iii) që ndodh më vonë). Tarifa e Menaxhimit është e kërkueshme për pagesë sapo të jetë nënshkruar kjo Marrëveshje, pavarësisht nëse Huaja është disbursuar plotësisht ose vetëm pjesërisht, ose nëse nuk është disbursuar.

5. Interesi

Huamarrësi do t'i paguajë interes KfW-së, si më poshtë:

5.1 Interesi (Norma Fikse e Interesit e caktuar pas angazhimit financiar të Huasë). Huamarrësi do të paguajë interes për Huan në një normë të përcaktuar nga KfW-ja në Ditën Bankare pas njoftimit për KfW-në se Marrëveshja është ratifikuar (Norma Fikse e Interesit) derisa kësti i fundit i shlyerjes të jetë marrë në përputhje me grafikun e shlyerjes, të përcaktuar në nenin 6.1 të kësaj Marrëveshjeje. KfW-ja do të njoftojë Huamarrësin për normën e interesit brenda pesë Ditësh Bankare pas përcaktimit të tij.

5.2 Llogaritja e interesit. Interesi mbi një shumë të disbursuar Huaje do të faturohet nga data (ekskluzivisht) në të cilën shuma përkatëse e Huas disbursohet nga shuma e Huas e mbajtur me KfW-në për Huamarrësin deri në datën (përfshirë) në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen në llogarinë e KfW-së, të përcaktuar në nenin 7.3 të Marrëveshjes. Interesi do të llogaritet në pajtim me nenin 7.1 të kësaj Marrëveshjeje.

5.3 Datat e Pagimit. Interesi do të jetë i kërkueshëm në shuma të prapambetura për pagesën në datat e përcaktuara më poshtë (secila e referuar si "Datë Pagimi"):

a) para datës së kërkueshme të kështit të parë të shlyerjes, në datat 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, për herë të parë në datën 30 qershor

2015, por jo më parë se në Datën e Pagimit, pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi dhe efekt në bazë të nenit 14.10 të kësaj Marrëveshjeje;

b) në datën e kërkueshme të kështit të parë të shlyerjes, në bazë të nenit 6.1 të kësaj Marrëveshjeje, së bashku me këtë këst;

c) më pas, në datat e kërkueshme të kësteve të shlyerjes në bazë të nenit 6.1 të kësaj Marrëveshjeje.

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 Grafiku i shlyerjes. Huamarrësi do të shlyejë Huan si më poshtë:

Kësti	Data	Shuma
1	30 qershor 2019	1.176.000,00 EURO
2	30 dhjetor 2019	1.176.000,00 EURO
3	30 qershor 2020	1.176.000,00 EURO
4	30 dhjetor 2020	1.176.000,00 EURO
5	30 qershor 2021	1.176.000,00 EURO
6	30 dhjetor 2021	1.176.000,00 EURO
7	30 qershor 2022	1.176.000,00 EURO
8	30 dhjetor 2022	1.176.000,00 EURO
9	30 qershor 2023	1.176.000,00 EURO
10	30 dhjetor 2023	1.177.000,00 EURO
11	30 qershor 2024	1.177.000,00 EURO
12	30 dhjetor 2024	1.177.000,00 EURO
13	30 qershor 2025	1.177.000,00 EURO
14	30 dhjetor 2025	1.177.000,00 EURO
15	30 qershor 2026	1.177.000,00 EURO
16	30 dhjetor 2026	1.177.000,00 EURO
17	30 qershor 2027	1.177.000,00 EURO

6.2 Shumat e padisbursuara të Huas. Shumat e padisbursuara të Huas do të kompensohen kundrejt kështit përkatës të shlyerjes së fundit të kërkueshëm në bazë të grafikut të shlyerjes së përcaktuar në nenin 6.1 të kësaj Marrëveshjeje, nëse KfW-ja, me diskrecionin e saj nuk zgjedh ndonjë alternativë tjetër kompensimi në raste individuale.

6.3 Shlyerja në rast disbursimi të paplotë. Nëse një këst shlyerjeje është i kërkueshëm para se Huaja të jetë disbursuar plotësisht, kjo nuk do të cenojë grafikun e shlyerjes në bazë të nenit 6.1 të kësaj Marrëveshjeje për sa kohë që kësti i shlyerjes, i kërkueshëm sipas grafikut të shlyerjes, është më i ulët sesa shuma e Huas e disbursuar dhe ende e pashlyer (Shuma e Papaguar e Huas). Nëse kësti i kërkueshëm i shlyerjes në pajtim me nenin 6.1 të kësaj Marrëveshjeje tejkalon shumën e papaguar të Huasë, ky këst i shlyerjes do të ulet në nivelin e Shumës së Papaguar dhe diferenca do të alokohet në mënyrë të barabartë për kështet e shlyerjes ende të papaguara. Në llogaritjen e Shumës së Papaguar të Huasë, KfW-ja rezervon të drejtën për të shqyrtuar disbursimet nga Huaja që bëhen brenda një periudhe prej 45 ose më pak ditësh para një Date Pagimi për përcaktimin e Shumës së Papaguar të Huasë vetëm për Datën tjetër të ardhshme të Pagesës.

6.4 Parapagimi. Sa më poshtë do të zbatohen për parapagimet:

a) E drejta për parapagim. Në bazë të paragrafëve të mëposhtëm 6.4/b deri 6.4/e të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi ka të drejtë të shlyejë shumat e Huas para datës së planifikuar të kërkueshme nëse ky parapagim është të paktën në shumën e një kësti të shlyerjes, në bazë të nenit 6.1 të kësaj Marrëveshjeje.

b) Njoftimi. Parapagimi i një shume Huaje në bazë të nenit 6.4/a të kësaj Marrëveshjeje i nënshtrohet njoftimit të parapagimit nga Huamarrësi për KfW-në jo më vonë se Ditën e pesëmbëdhjetë Bankare (siç përcaktohet në nenin 13.1 të kësaj Marrëveshjeje) para datës së synuar të parapagimit. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të specifikojë datën dhe shumën e parapagimit dhe detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e caktuar.

c) Kompensimi i Parapagimit. Nëse Huamarrësi parapaguan një shumë Huaje me interes fiks, Huamarrësi do t'i paguajë KfW-së menjëherë, sipas kërkesës, atë shumë që është e nevojshme për të kompensuar çdo humbje, shpenzim ose kosto të shkaktuar nga KfW-ja si rezultat i këtij parapagimi. KfW-ja do të përcaktojë shumën e Kompensimit të Parapagimit dhe do t'ia komunikojë këtë Huamarrësit. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një të dhënë mbi shumën e tarifës së parapagimit para njoftimit të kërkuar të parevokueshëm të shlyerjes në bazë të nenit 6.4/b të kësaj Marrëveshjeje.

d) Shumat e kërkueshme. Së bashku me parapagimin në bazë të nenit 6.4/a të kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paguajë shumat e mëposhtme:

i) Çdo Kompensim Parapagimi të kërkueshëm si rezultat i parapagimit në bazë të nenit 6.4/c të kësaj Marrëveshjeje; dhe

ii) Të gjitha interesat e shtuara mbi shumën e parapaguar të Huas dhe çdo pagesë tjetër ende e papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje që janë shtuar deri në datën e parapagimit.

e) Kompensimi. Neni 6.2 i kësaj Marrëveshjeje do të zbatohet *mutatis mutandis* për kompensimin e parapagimeve.

Grafiku i rishikuar i shlyerjeve. Nëse zbatohet neni 6.3 ose neni 6.4 i kësaj Marrëveshjeje, KfW-ja do t'i dërgojë Huamarrësit një grafik të rishikuar shlyerjeje që do të bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje dhe do të zëvendësojë grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë kohë.

7. Llogaritjet dhe pagesat në përgjithësi

7.1 Llogaritja. Interesi, Tarifa e Angazhimit Financiar, kamatëvonesa në pajtim me nenin 7.5, kompensimi i plotë për shumat e prapambetura në pajtim me nenin 7.6 të kësaj Marrëveshjeje, Kompensimi i Mospranimit dhe Kompensimi i Parapagimit do të llogariten mbi bazën e një viti me 360 ditë me muaj me tridhjetë ditë.

7.2 Data e kërkueshme. Nëse një pagesë që duhet të kryhet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje bëhet e kërkueshme në një datë që nuk është Ditë Bankare, Huamarrësi duhet ta kryejë këtë pagesë në Ditën Bankare pasuese. Nëse Dita pasuese Bankare bie në muajin e ardhshëm kalendarik, kjo pagesë duhet të kryhet në Ditën e fundit Bankare të muajit kalendarik aktual.

7.3 Numri i llogarisë, koha e kreditimit. Huamarrësi do të lirohet nga detyrimet e tij të pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje nëse dhe deri në masën që shumat përkatëse do t'i jenë kredituar KfW-së në disponim të saj të lirë pa asnjë zbritje në euro dhe jo më vonë se ora 10:00 paradite në Frankfurt am Main, Republika Federale e Gjermanisë, në llogarinë e KfW-së në Frankfurt am Main, Republika e Gjermanisë, numër IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01, që përcakton datën e kërkueshme si një referencë shtesë (Ref. VVVVMMDD).

7.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë asnjë të drejtë mbajtjeje ose kompensimi apo të drejta të ngjashme ndaj detyrimeve për pagesa sipas kësaj Marrëveshjeje, nëse këto të drejta nuk njihen nga vendimi deklarues mbi përcaktimin e pasigurisë juridike ose nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

7.5 Kamatëvonesa. Nëse ndonjë këst shlyerjeje ose parapagim sipas nenit 6.4 nuk janë në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të caktojë kamatëvonesë në normën prej 200 pikë bazë mbi normën e interesit në vit të përcaktuar në nenin 5.1 për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën në të cilën këto pagesa kreditohen në llogarinë e KfW-së, të specifikuar në nenin 7.3. Kjo kamatëvonesë duhet të paguhet menjëherë me kërkesën fillestare të KfW-së.

7.6 Kompensimi me shumë të plotë. Për shumat e prapambetura (me përjashtim të kësteve të shlyerjeve dhe parapagimeve të përmendura në nenin 6.4 të kësaj Marrëveshjeje), KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë kompensim në shumë të plotë me një normë prej 200 pikë bazë në vit mbi Normën Fikse të Interesit në bazë të nenit 5.1. Kompensimi në shumë të plotë duhet të paguhet menjëherë pas kërkesës fillestare të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të provojë që nuk është shkaktuar asnjë dëm ose që dëmet kanë qenë në shuma më të vogla sesa kompensimi në shumë të plotë.

7.7 Kompensimi. KfW-ja ka të drejtë të kompensojë pagesat e marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjeve të tjera të Huas, të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Për shmangien e dyshimit, kjo do të zbatohet veçanërisht në rastin e një mospagimi apo mospagimi të mundshëm nga Huamarrësi.

7.8 Llogaritë e bëra nga KfW-ja. Në mungesë të gabimeve të dukshme, vlerat e llogaritura nga KfW-ja dhe llogaritjet e kryera nga KfW-ja të shumave të kërkueshme në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje përbëjnë të dhëna provuese *prima facie* (Anscheinsbeweis).

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja do të ketë pretendime pagese sipas kësaj Marrëveshjeje të garantuara nga Republika Federale e Gjermanisë para disbursimit të parë.

9. Kostot dhe detyrimet publike

9.1 Ndalimi i zbritjeve ose mbajtjeve. Huamarrësi do të kryejë të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje pa asnjë zbritje për taksat, detyrimet e tjera publike ose kosto të tjera. Në rastin kur

Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për arsye të tjera që të bëjë zbritje ose ndalesa të tilla mbi pagesat, pagesat e kryera nga Huamarrësi do të rriten në atë shumë që është e nevojshme për KfW-në, në mënyrë që të marrë të plotë shumat e kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje pas zbritjes së taksave dhe detyrimeve.

9.2 Kostot. Huamarrësi do të mbulojë të gjitha shpenzimet dhe kostot që shkaktohen në lidhje me disbursimin dhe shlyerjen e Huas, veçanërisht kostot e dërgimit dhe transferimit (duke përfshirë tarifat e konvertimit), si dhe të gjitha kostot dhe shpenzimet që shkaktohen në lidhje me ruajtjen ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3 Taksat dhe detyrimet e tjera. Huamarrësi do të mbulojë të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që lindin jashtë Republikës Federale të Gjermanisë mbi lidhjen dhe nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse KfW-ja parapaguan këto taksa ose detyrime, Huamarrësi do t'i transferojë ato pa vonesë, me kërkesë, në llogarinë e KfW-së, të përcaktuar në nenin 7.3 të kësaj Marrëveshjeje ose në ndonjë llogari tjetër të përcaktuar nga KfW-ja.

10. Detyrime të veçanta

10.1 Detyrimet e lidhura me Programin e Agjencisë për Zbatimin e Projektit. Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të përgatitë, zbatojë, operojë dhe administrojë Programin në pajtim me praktikat e qëndrueshme financiare dhe teknike dhe kryesisht në pajtim me konceptimin e Projektit të rënë dakord ndërmjet Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) do t'ia delegojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Programit inxhinierëve konsultues ose konsulentëve të kualifikuar, të pavarur dhe zbatimin e Projektit për firma të kualifikuara;

c) do të japë kontrata për mallra dhe shërbime që duhet të financohen nga Huaja (neni 10.1/b) i kësaj Marrëveshjeje, pas ofertimit paraprak konkurrues ndërkombëtar, nëse asnjë procedurë tjetër nuk do të bihet reciprokisht dakord ndërmjet Huamarrësit, Agjencisë së Zbatimit të Projektit dhe KfW-së në Marrëveshjen e Veçantë që do të nënshkruhet;

d) do të mbajë libra dhe regjistra ose do të marrë masa për mbajtjen e librave dhe regjistrave që përcaktojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

e) do t'i japë mundësinë, në çdo kohë KfW-së dhe agjentëve të saj, që të inspektojnë këta libra dhe regjistra dhe të gjithë dokumentacionin tjetër të lidhur me zbatimin dhe operimin e Programit, si dhe të vizitojnë Programin dhe të gjitha objektet e lidhura me të;

f) do t'i japë KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhëna të tjera të tilla në lidhje me Programin dhe progresin e tij të mëtejshëm që KfW-ja mund të kërkojë; dhe

g) menjëherë dhe me iniciativë të vet do t'i paraqesë KfW-së çdo pyetje të marrë nga Huamarrësi nga OECD-ja ose anëtarët e tij sipas të ashtuquajturës "Marrëveshje për Transparencën e Kredive të bashkuara të ODA-s" pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja dhe do të koordinojë përgjigjet e këtyre pyetjeve me KfW-në.

10.2 Detaje të zbatimit të Projektit. Huamarrësi, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë në lidhje me nenin 10.1 me Marrëveshje të Veçantë.

10.3 Detyrimet e përbashkëta të lidhura me Programin. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) do të garantojnë financimin e plotë të Programit dhe do t'i japin KfW-së, sipas kërkesës, të dhëna që provojnë se kostot e papaguara nga kjo Hua janë mbuluar; dhe

b) menjëherë dhe me iniciativën e tyre do të njoftojnë KfW-në në lidhje me të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Programit.

10.4 Detyrimet e Huamarrësit të lidhura me Programin. Huamarrësi do të ndihmojë Agjencinë e Zbatimit të Projektit në pajtim me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike për zbatimin e Programit dhe përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë së Zbatimit të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe, në veçanti, do t'i japë Agjencisë së Zbatimit të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Programit.

10.5 Pajtueshmëria. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit do të garantojnë që personat e ngarkuar për përgatitjen dhe zbatimin e Programit, dhënien e kontratës për furnizimet

dhe shërbimet që do të financohen dhe kërkimin e shumave të Huas, nuk kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin, premtojnë apo pranojnë premtimin e pagesave të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

10.6 Transporti i furnizimeve. Dispozitat e përcaktuara në Marrëveshjen Qeveritare do të zbatohen për transportin e furnizimeve që do të financohen nga Huaja.

10.7 Pastrimi i parave. Agjencia e Zbatimit të Projektit do t'i vërë menjëherë në dispozicion KfW-së, sipas kërkesës, të gjithë informacionin dhe dokumentet që KfW-ja kërkon për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënies së tij të biznesit me Agjencinë e Zbatimit të Projektit që është i nevojshëm për këtë qëllim.

Duke lidhur dhe zbatuar këtë Marrëveshje, Agjencia e Zbatimit të Projektit vepron në emër dhe në llogari të saj. Për sa i përket ligjit gjerman ose ligjit të vendit të themelimit të Agjencisë së Zbatimit të Projektit.

a) Burimet e veta të Agjencisë së Zbatimit të Projektit ose shumat e investuara në financimin e Programit nuk do të jenë me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, kur kjo listë nuk është përfundimtare, nuk do të shoqërohet me trafikim droge, korrupsion, veprimtari krimi të organizuar ose terrorizëm;

b) Kapitali aksionar i Agjencisë së Zbatimit të Projektit, në asnjë rast, nuk do të jetë me origjinë të paligjshme dhe, në veçanti, kur kjo listë nuk është përfundimtare, në asnjë rast, nuk do të lidhet me trafikimin e drogës, korrupsionin, krimin e organizuar ose terrorizmin;

c) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të përfshihet në blerjen, zotërimin ose përdorimin e pronës që është me origjinë të paligjshme;

d) Agjencia e Zbatimit të Projektit, në asnjë rast, nuk do të shoqërohet me trafikim droge, korrupsion, veprimtari të krimit të organizuar ose terrorizëm, kur kjo listë nuk është përfundimtare;

e) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të përfshihet në financimin e terrorizmit.

10.8 Klasifikimi *pari passu*. Huamarrësi garanton dhe përfaqëson se detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen dhe do të përdoren të paktën *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera të pasiguruara dhe jo të varura, dhe Huamarrësi do të garantojë në masën e lejuar me ligj që ky klasifikim të garantohet edhe për të gjitha detyrimet e ardhshme të pasiguruara dhe jo të varura.

10.9 Detyrimet. Huamarrësi dhe Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të krijojnë ose lejojnë vazhdimin e ndonjë detyrimi mbi sendet pasurore të Programit pa pëlqimin paraprak të KfW-së. Një detyrim konsiderohet të jetë një e drejtë reale përdorimi, realizimi ose e drejtë tjetër për të siguruar llogaritë e arkëtueshme ose të drejta të ngjashme kolaterali.

Ky detyrim nuk zbatohet:

a) për detyrimet që ekzistojnë ose tashmë të rëna dakord kur kjo Marrëveshje ishte nënshkruar dhe i ishte njoftuar KfW-së para nënshkrimit të Marrëveshjes;

b) për detyrimet e krijuara në drejtimin e rregullt të biznesit sipas rregulloreve ligjore ose rregulloreve të tjera të zakonshme kontraktuale për sigurimin e detyrimeve (me përjashtim të detyrimeve të Huas) ndaj furnizuesve ose ofruesve të tjerë të shërbimeve (për shembull, ruajtja e të drejtave për tituj si të zakonshme në industri dhe barrët ligjore); ose

c) për detyrimet që tashmë ekzistonin në kohën e blerjes së një sendi pasuror, me kusht që këto tarifa të eliminohen brenda tre muajsh pas blerjes.

Nëse Huamarrësi ose Agjencia e Zbatimit të Projektit i jep ndonjë pale të tretë garanci ose të drejta të tjera që i mundësojnë kësaj pale të tretë të kërkojë përmbushje preferenciale të pretendimeve ndaj ndonjë prej sendeve pasurore, pronave ose të ardhurave të Projektit, KfW-ja mund t'ia nënshtrojë pëlqimin e saj Huamarrësit, duke i dhënë edhe KfW-së garanci (shtesë) në të njëjtën masë që në mënyrë të barabartë dhe proporcionale siguron pretendimet e KfW-së ndaj Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje.

10.10 Shitja e sendeve pasurore. Pa pëlqimin paraprak të KfW-së, as Huamarrësi as Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të shesin ndonjë prej sendeve pasurore të Programit nëse vlerat e tregut që do të përcaktohen në datën përkatëse të shitjes për sendet pasurore që do të shiten tejkalojnë shumën e përgjithshme prej 20 milionë eurosh.

11. Zgjidhja e Marrëveshjes

11.1 Arsyet për zgjidhjen e Marrëveshjes. KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në nenin 11.2 (Pasojat ligjore të ndodhjes së një arsyeje për zgjidhjen e Marrëveshjes) nëse lind një rrethanë që përbën arsye të fortë (*wichtiger Grund*). Këto përfshijnë, në veçanti, rrethanat e mëposhtme:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet e pagesës ndaj KfW-së kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje ose sipas Marrëveshjes së Veçantë, si dhe ndonjë marrëveshjeje tjetër shtesë ligjërisht detyruese të kësaj Marrëveshjeje, janë shkelur;

c) kjo Marrëveshje ose ndonjë pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues ndaj Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit ose nuk mund të jetë më e zbatueshme ndaj Huamarrësit ose Agjencisë së Zbatimit të Projektit;

d) ndonjë deklaratë, konfirmim, informacion, përfaqësim ose garanci e konsideruar nga KfW-ja thelbësore për dhënien dhe mbajtjen e Huas, rezulton e rreme, çorientuese ose e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;

f) Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk mund të provojë se shumat e Huas janë përdorur për qëllimin e caktuar; ose

g) Huamarrësi ndërpret pagesat e tij ndaj kreditorëve, nuk ka aftësi paguese ose fillon negociatat me një ose më shumë prej kreditorëve të Huamarrësit mbi një moratorium, heqje dorë nga borxhet e papaguara, shtyrje të pagesave ose ndërprerje të shërbimit të borxhit.

11.2 Pasojat ligjore të ndodhjes së një arsyeje për zgjidhjen e Marrëveshjes. Nëse ka ndodhur një prej rasteve të përmendura në nenin 11.1, KfW-ja mund të pezullojë menjëherë disbursimet sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse ky rast nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej pesë ditësh (në rastin e nenit 11.1/a të kësaj Marrëveshjeje ose në të gjitha rastet e tjera të specifikuara në nenin 11.1 brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja që gjithsesi duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të anulojë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, me pasojën që detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje ndërpriten, dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të plotë ose të pjesshme të Shumës së Papaguar të Huas së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Nenet 7.5 dhe 7.6 zbatohen *mutatis mutandis* për shumat e përshpejtuara.

11.3 Kompensimi për dëmet. Nëse kjo Marrëveshje zgjidhet plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi do të paguajë Kompensimin e Mospranimit në pajtim me klauzolën 3.6 dhe/ose Kompensimin e Parapagimit në pajtim me klauzolën 6.4/c.

12. Publikimi dhe transferimi i informacionit lidhur me projektin.

12.1 Publikimi i informacionit lidhur me Programin nga KfW-ja. Në përputhje me parimet e pranuara ndërkombëtarisht të transparencës së jashtme dhe efikasitetit në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacion të përzgjedhur (përfshirë raportet e vlerësimit) për Programin dhe se si financohet gjatë negociatave para kontraktuale, ndërsa marrëveshja/et lidhur me Programin është (janë) duke u zbatuar dhe në fazën pas kontraktuale (tani e tutje referuar si "E gjithë periudha").

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të KfW-së për zonën e tij të biznesit "KfW Banka e (http://transparenz.kfw-entcklungsbank.de).

Publikimi i informacionit (nga KfW-ja ose nga palët e treta në përputhje me nenin 12.3 më poshtë) rreth Programit dhe se si financohet nuk përfshin ndonjë dokument kontraktual ose ndonjë informacion të detajuar të ndjeshëm financiar, ose lidhur me biznesin rreth palëve të përfshira në Projekt ose të financuarit e tij, si:

a) informacion rreth të dhënave financiare të brendshme;

b) strategjitë e biznesit;

c) udhëzimet e brendshme të korporatave dhe raportet;

d) të dhëna personale të personave fizikë;

e) Vlerësimi i brendshëm i KfW-së i pozicionit financiar të palëve.

12.2 Transferimi i informacionit lidhur me Programin te palët e treta. KfW-ja ndan informacion të përzgjedhur rreth programit dhe se si financohet gjatë gjithë periudhës me subjektet e përmendura më poshtë, veçanërisht për të siguruar transparencë dhe efikasitet.

a) Filialet e KfW-së

b) Republika Federale Gjermane dhe organet, autoritetet, institucionet, agjencitë dhe subjektet e saj kompetente;

c) Organizatat të tjera zbatuese përfshirë në bashkëpunimin e zhvillimit dypalësh gjerman, veçanërisht Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit) (GIZ) GmbH;

d) Organizatat ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarët e tyre, veçanërisht Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OBZHE) dhe anëtarët e saj.

12.3 Transferimi i informacionit lidhur me Programin te palët e treta dhe publikimi nga palët e treta. Për më tepër, Republika Federale Gjermane i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur rreth Programit dhe se si financohet përgjatë gjithë Periudhës me subjektet e mëposhtme, të cilat publikojnë seksionet përkatëse me qëllimin:

a) Republika Federale Gjermane me qëllimet e Iniciativës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare http://www.bmz.de/de/was wirmachen/wege/transparenz-fuer-mehr-Wirksamkeit/index.html);

b) Tregtia dhe Investimi Gjerman (TIGj) për qëllimet e informacionit tregtar (http://www.gtai.de/GTAI/Nasvigation/DE/tradeFOO).

c) OBZHE-ja për qëllimin e raportimit të rrjedhës financiare në kuadrin e bashkëpunimit të zhvillimit (http://wwwstats.oecd.org/);

Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim për të siguruar transparencë dhe efikasitet (http://www.deval.org/de/).

12.4 Transferimi i mëtejshëm i informacionit lidhur me Programin te palët e treta (përfshirë publikimin nga këto palë të treta). KfW-ja më tej ka të drejtë të transferojë (përfshirë qëllimet e publikimit) informacion rreth Projektit dhe se si financohet gjatë gjithë Periudhës te palët e treta në mënyrë që të ruajë interesat legjitime.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja te palët e treta nëse interesi legjitim i Huamarrësit ose Agjencia e Ekzekutimit të Projektit në informacionin e patransferuar peshon më shumë se interesat e KfW-së në informacionin e transferuar. Interesi legjitim i Huamarrësit ose Agjencia e Ekzekutimit të Projektit, veçanërisht përfshijnë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm të përmendur në nenin 12.1, i cili është i përjashtuar nga publikimi.

Për më tepër, KfW-ja është caktuar t'i transferojë informacion palëve të treta nëse ky është i nevojshëm për shkak të kërkesave rregullatore ose statutore, të mbrojë pretendime ose të drejta të tjera ligjore në gjykatë ose në procedime administrative.

13. Përfaqësimi dhe deklaratat

13.1 Përfaqësimi i Huamarrësit. Ministri i Financave i caktuar në KfW nga ai/ajo dhe autorizuar me ekzemplarë të nënshkrimeve. E vërtetuar nga ai/ajo dhe do të përfaqësojë Huamarrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit dhe këta persona të caktuar në KfW nga ai/ajo dhe të autorizuar me ekzemplarë të nënshkrimeve të vërtetuar nga ai/ajo do të përfaqësojnë Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk do të skadojë deri sa revokimi i tij i shprehur nga përfaqësuesi i Huamarrësit i autorizuar në këtë kohë të jetë marrë nga KfW-ja.

13.2 Adresat: Deklarimet ose njoftimet në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jenë më shkrim. Ato duhet të dërgohen si origjinale ose – me përjashtimin e kërkesave për disbursim – nëpërmjet faksit. Të gjitha deklarimet ose njoftimet të bëra në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në: KfW Postfach 11 11 41 60046
Frankfurt am Main
Gjermani
Faks: +49 69 7431 2944
Për Huamarrësin: Republika e Shqipërisë
Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorë e Kombit", nr. 3
Tiranë
Faks: +355 42 228494
Për Agjencinë e Ekzekutimit të Projektit:
Korporata Energjetike Shqiptare sh.a.
Blloku "Vasil Shanto"
Tiranë
Faks: +355 4 2257135

13.3 Çdo amendament ose modifikim i kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe duhet

të bihet dakord nga të gjitha palët. Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim i cili duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që ndikojnë vetëm periudhën e vlefshmërisë nuk do të kërkojnë miratim paraprak nga këshilli i Ministrave. Amendamentet e kësaj Marrëveshjeje që ndikojnë vetëm marrëdhënien ligjore ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit nuk do të kërkojnë miratim nga Agjencia e Ekzekutimit të Projektit.

14. Dispozitat të përgjithshme

14.1 Dita Bankare. Kur bëhet referenca në këtë Marrëveshje në një "Ditë Bankare" kjo nënkupton një ditë përveç të shtunës ose të dielës në të cilat bankat tregtare në Frankfurt Main, Republika Federale Gjermane janë të hapura për punë të përgjithshme.

14.2 Vendi i zbatimit. Vendi i zbatimit për të gjitha detyrimet nën këtë Marrëveshje është Frankfurt am Main, Republika Federale Gjermane.

14.3 Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet. Nëse ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është apo bëhet e pavlefshme, ose nëse është ndonjë boshllëk në ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, kjo nuk do të ndikojë në vlefshmërinë e dispozitave këtu. Palët e kësaj Marrëveshjeje do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme nga një dispozitë ligjërisht e vlefshme, e cila i afrohet sa më shumë frymës së qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët do të mbushin çdo boshllëk në dispozitat me një dispozitë ligjore të vlefshme, e cila i afrohet sa më shumë të jetë e mundur qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

14.4 Forma e shkruar. Çdo shtesa dhe amendamente në këtë Marrëveshje duhet të jenë me shkrim. Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e formës së shkruar vetëm me shkrim.

14.5 Detyra. As Huamarrësi as Agjencia e Ekzekutimit të Projektit nuk mund të shpërndajë, transferojnë, të lënë garanci ose peng ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje huaje.

14.6 Ligji i aplikueshëm. Kjo Marrëveshje udhëhiqet nga ligji gjerman.

14.7 Periudha e limituar. Të gjitha pretendimet e KfW-së nën këtë Marrëveshje skadojnë pas pesë vitesh që në fund të vitit në të cilin ky pretendim është ngritur dhe në të cilin KfW-ja është vënë në dijeni të rrethanave që përbëjnë këtë pretendim ose mund të jenë vënë në dijeni të tyre pa neglizhencë bruto.

14.8 Heqja dorë nga imuniteti. Nëse dhe në masën që Huamarrësi tani ose në të ardhmen në ndonjë juridiksion pretendon imunitet për veten ose për asetet e tij dhe në masën që një juridiksion jep imunitet Huamarrësit dhe aseteve të tij nga padia, ekzekutimi, shtojcë ose proces tjetër ligjor, Huamarrësi në mënyrë të parevokueshme bie dakord të heqë dorë nga ky imunitet për pretendime nga dhe në lidhje me këtë huadhënie dhe Marrëveshje Projekti në masën më të plotë të lejuar nga ligjet apo ky juridiksion. Huadhënësi nuk heq dorë nga imuniteti në lidhje me:

i) "ambientet e misionit" aktuale ose të ardhme siç janë përcaktuar në Konventën e Vjenës në Marrëdhëniet Diplomatike firmosur në vitin 1961, "ambientet konsullore" aktuale dhe të ardhme siç janë përcaktuar në Konventën e Vjenës në Marrëdhëniet Konsullore firmosur në vitin 1963, ose ndryshe përdorur nga një diplomat ose mision diplomatik në Shqipëri;

ii) çdo pasuri e paluajtshme që bie nën nenin 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr. 8743 i datës 22.2.2001 "Mbi gjendjen e pasurive të paluajtshme";

iii) çdo fond monetar ose shumë e cila ka qenë shkak dhe është paguar në momentin ose ekzekutimin për përmbushjen e detyrimeve të Republikës së Shqipërisë sipas ligjit publik, traktate ndërkombëtare, konventa ose marrëveshje të nënshkruara nga ai.

14.9 Mosmarrëveshjet ligjore. Të gjitha mosmarrëveshjet e lindura nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje Huadhënie do të vendosen ekskluzivisht dhe së fundmi nga një Gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, do të aplikohen si vijon:

i) Gjykata e arbitrazhit do të konsistojë në një ose tre arbitër, të cilët do të caktohen dhe do të veprojnë në përputhje me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtarë të Tregtisë (DHNT) të zbatueshme herë pas here.

ii) Procedimet e Arbitrazhit do të kryhen në Frankfurt am Main. Gjuha e procedimeve do të jetë gjuha angleze.

14.10 Hyrja në fuqi dhe efekti. Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi dhe nuk do të ketë efekt deri kur:

i) Huamarrësi e ka informuar KfW-në me shkrim që Marrëveshja e Huadhënies është ratifikuar dhe ratifikimi i saj është publikuar në mënyrë të duhur; dhe

ii) Marrëveshja Qeveritare në të cilën është bazuar ka hyrë në fuqi dhe në efekt.

Nëse Marrëveshja nuk do të ketë hyrë në fuqi më 15 tetor 2015, KfW-ja që nga ajo datë dhe deri në datën e hyrjes në fuqi do të ketë të drejtën të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja dhe kështu të përfundojë varësinë e saj duke i dërguar një njoftim me shkrim Huadhënësit.

Hartuar në 3 origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, Tiranë_____

KfW

Republika e Shqipërisë, e Përfaqësuar nga Ministri i Financave

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare sh.a.

ANEKSI 1
PLANI I DISBURSIMIT

Plani më i shpejtë i mundshëm për disbursim

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi ("Data e hyrjes në fuqi e fundit e periudhës" në përputhje me listën më poshtë), Huamarrësi mund të kërkojë disbursim vetëm deri në nivelin që nuk e tejkalon shumën e akumuluar të disbursimit e specifikuar në tabelën më poshtë.

Periudha	**Data e hyrjes në fuqi e fundit të periudhës**	**Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në fund të periudhës (akumuluese) (të gjitha shifrat në euro)**
1	30.06.2015	0.00
2	30.12.2015	3,000,000.00
3	30.06.2015	6,000,000.00
4	30.12.2016	10,000,000.00
5	30.06.2017	14,000,000.00
6	30.12.2017	17,000,000.00
7	30.06.2018	19,000,000.00
8	30.12.2018	20,000,000.00

ANEKSI 2
FORMULARI I OPINIONIT LIGJOR TË KËSHILLTARIT LIGJOR TË HUAMARRËSIT

(Letër me kokë e Këshilltarit Ligjor)
KfW
Departamenti_____ (datë)
Në vëmendje të:_____
Palmengartenstrasse 5-9
Kutia postare 11 11 41
60325 Frankfurt am Main /Gjermani
Republika Federale Gjermane

Marrëveshje e Huas dhe e Projektit, e datës_____dhe e lidhur ndërmjet KfW-së dhe_____ (Huamarrësi) dhe (_____) (Agjencia e Ekzekutimit të Projektit) për një shumë që nuk kalon në total 20.000.000 euro

Të nderuar zotërinj,

Unë jam (Ministri i Drejtësisë i) (Këshilltar Ligjor në) (kryetar i departamentit ligjor i) _____ (ju lutemi, specifikoni ministrinë ose autoritet tjetër) i Republikës së Shqipërisë. Kam vepruar në atë cilësi në lidhje me një Marrëveshje të Huas dhe Projektit, e datës _____

(Marrëveshja e Huas dhe Projektit) dhe e bërë ndërmjet Huamarrësit dhe vetë ju në lidhje me një kredi që do të jepet nga vetë ju Huamarrësit për një shumë që nuk kalon në total 20.000.000 euro,--.

1. Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar

1.1 një dokument autentik origjinal të nënshkruar, e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit;

1.2 dokumentet themeluese të Huamarrësit, në veçanti:

a) Kushtetuta e Republikës e VENDI, i datës_____, e publikuar në mënyrë të rregullt në ___, nr._____, faqe___, i ndryshuar;

b) Ligji(et) nr._____ i datës_____, e publikuar në mënyrë të rregullt në _____, nr._____, faqe___, i ndryshuar (ju lutemi referoni këtu, nëse ekzistojnë, ligje (p.sh. ligjet e buxhetit) në lidhje me huamarrjen e parave nga Republika e VENDI;

c) _____ (ju lutemi referoni këtu dokumente të tjera, p.sh., dekrete ose rezoluta nga organet qeveritare ose administrative të VENDI në lidhje me Përfundimin e marrëveshjeve të huas nga VENDI, në përgjithësi, ose në lidhje me përfundimin e marrëveshjes së huas dhe të projektit); dhe

d) Marrëveshja përfundimtare e Bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së VENDI dhe Qeveria e Republikës Federale Gjermane, i datës _____ (Marrëveshja e Bashkëpunimit);

dhe të tjera ligje, rregullore, certifikata, të dhëna, regjistrime dhe dokumente, të cilat unë i kam konsideruar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllimin e dhënies së këtij mendimi.

2. Opinioni

Për qëllimin e nenit____ Marrëveshjes së Huas dhe Projektit, jam i mendimit se sipas ligjeve të Republikës së VENDI, në datën këtu:

2.1 Sipas nenit _____të Kushtetutës / nenit _____ së ligjit më _____ (ju lutemi specifikoni sipas rastit) Huamarrësi caktohet të hyjë në Marrëveshjen e Huas dhe Projektit dhe ka marrë të gjitha veprimet e nevojshme, të autorizojë ekzekutimin, dorëzimin dhe kryerjen e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit, në veçanti duke u mbështetur në:

a) Ligji(et) nr._____ i datës _____të parlamentit të Republikës së VENDI, e cila ratifikon Marrëveshjen e Huas dhe Projektit që aprovon ekzekutimin, dorëzimin dhe kryerjen e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit nga Huamarrësi / _____(ju lutemi specifikoni sipas rastit);

b) Rezoluta(t) nr._____, i datës_____i Kabinetit të Ministrave i komitetit shtetëror të huas / _____ (ju lutemi shënoni organet qeveritare ose administrative të VENDI, sipas rastit);

c) _____(ju lutemi referoni rezolutat, vendimet e tjera etj.).

2.2 Znj./z._____ (dhe znj./z. _____) është (janë) autorizuar në mënyrë të rregullt nga _____(p.sh. nga ligji për shkak të pozitës së tij/saj (si Ministër i _____/ si _____), nga rezoluta qeveritare_____, me prokurën e _____i datës_____ etj.) të nënshkruajë vetëm / bashkërisht Marrëveshjen e Huas dhe Projektit në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e Huas dhe Projektit e nënshkruar nga Znj./Z. _____ (dhe znj./z. _____) është ekzekutuar në mënyrë të rregullt në emër të Huamarrësit dhe konsiston obligimet juridikisht të detyrueshme të Huamarrësit e zbatueshme kundër tij në ligj në përputhje me kushtet e saj.

(Alternativa 1 për seksionin 2.3, të përdoret nëse si shtesë të dokumenteve të specifikuara në seksionet 2.1 dhe 2.2, autorizime zyrtare të veçanta etj. Duhet të mbahen sipas ligjeve të Republikës së VENDI)

2.3 Për ekzekutimin dhe kryerjen e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit nga Huamarrësi (përfshirë pa asnjë kufizim marrjen dhe transferimin në KfW të të gjitha shumave në përputhje me to për shkak të monedhave të specifikuara aty), aprovimet zyrtare, autorizimet, licencat, regjistrimet e mëposhtme dhe pëlqimet janë marrë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë:

a) Miratimi i _____(Banka Qendrore/Banka Kombëtare/_____), i datës_____, nr._____;

b) Pëlqimi i _____(Ministër/Ministria e _____) i datës_____, nr._____; dhe

c) _____(ju lutemi listoni autorizime, licenca, regjistrime të tjera dhe/ pëlqime).

Autorizime zyrtare, pëlqime, licenca, regjistrime dhe miratime të çdo autoriteti qeveritar apo agjencie (përfshirë Bankën Qendrore/ Bankën Kombëtare të Republikës së VENDI) ose gjykata ose kërkohet e kështillueshme në lidhje me ekzekutimin dhe kryerjen e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit nga Huamarrësi (përfshirë pa asnjë kufizim marrjen dhe transferimin në KfW të të gjitha shumave në përputhje me to për shkak të monedhave të specifikuara aty) dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas dhe Projektit.

(Alternativa 2 për seksionin 2.3, të përdoret nëse si shtesë të dokumenteve të specifikuara në seksionet 2.1 dhe 2.2 asnjë autorizim zyrtar etj. Duhet të mbahen sipas ligjeve të Republikës së VENDI)

2.3 Asnjë autorizim zyrtar, pëlqime, licenca, regjistrime dhe miratime të çdo autoriteti qeveritar apo agjencie (përfshirë Bankën Qendrore/Bankën Kombëtare të Republikës së VENDI) ose gjykata ose kërkohet e kështillueshme në lidhje me ekzekutimin dhe kryerjen e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit nga Huamarrësi (përfshirë pa asnjë kufizim marrjen dhe transferimin në KfW të të gjitha shumave në përputhje me to për shkak të monedhave të specifikuara aty) dhe vlefshmërinë dhe zbatueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas dhe Projektit.

2.4 Asnjë taksë pullë ose taksë e ngjashme apo detyrim nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë e zbatueshmërisë e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit.

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të qeverisur Marrëveshjen e Huas dhe Projektit dhe paraqitja në arbitrazh në përputhje me nenin _____ e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit janë të vlefshme dhe detyruese. Vendimet e arbitrazhit kundrejt Huamarrësit do të njihen dhe do të jenë të zbatueshme në Republikën VENDI sipas rregullave të mëposhtme: _____ (ju lutemi shënoni traktatin e zbatueshëm (nëse ka), p.sh., Konventa e Nju-Jorkut në vitin 1958, dhe bazat parimore në lidhje me njohjen dhe zbatimin e vendimeve të arbitrazhit në VENDI).

2.6 Gjykatat e Republikës së VENDI janë në liri për të dhënë gjykim të shprehur në valutën apo valutat e specifikuar në Marrëveshjen e Huas dhe Projektit.

2.7 Huamarrja nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së Huas dhe Projektit dhe ekzekutimi dhe zbatimi nga Huamarrësi i Marrëveshjes së Huas dhe Projektit konsiston në veprime private dhe tregtare dhe jo në veprime qeveritare dhe publike. As Huamarrësi e as ndonjë prej pasurisë së tij nuk ka të drejtë ose imunitet nga arbitrazhi, padia, ekzekutimi, shtojca ose proces tjetër ligjor.

2.8 Marrëveshja e Bashkëpunimit është në fuqi dhe efekt të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së VENDI. (Sipas nenit 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit) (nëse Marrëveshja e Bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi, por ekziston një marrëveshje e dyfishtë tatimi). Në pajtim me _____(ju lutemi specifikoni traktatin ose ligjet e aplikueshme dhe rregullat). Huamarrësit nuk i kërkohet të bëjë ndonjë zbritje apo mbajtje në burim nga çdo pagesë që Huamarrësi duhet të bëjë sipas Marrëveshjes së Huas dhe Projektit, ndonjë zbritje apo mbajtje e tillë në burim duhet të imponohet më pas, dispozitat e nenit_____ e Marrëveshjes së Huas dhe Projektit do të operojnë kështu dhe në mënyrë që të kërkojë nga Huamarrësi për të dëmshpërblyer KfW-në në përputhje me rrethanat.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk do të konsiderohet rezident, banues në kryerjen e biznesit ose të jetë subjekt i tatimit në Republikën e VENDI për shkak vetëm të ekzekutimit, kryerjes ose zbatimit të Marrëveshjes së Huas dhe Projektit. Nuk është e nevojshme ose e kështillueshme që KfW-ja të licencohet, kualifikohet ose ndryshe të emërtohet që të vazhdojë biznesin, ose që KfW-ja të caktojë agjentë ose përfaqësues në Republikën e VENDI.

Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huas dhe Projektit konsistojnë direkt dhe pa kushte detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të Huamarrësit, të cilat janë të detyrueshme kundrejt Huamarrësit në përputhje me kushtet e tyre përkatëse.

Ky mendim ligjor është i kufizuar në ligjet e Republikës së VENDI.

_____, _____
(vendi) (data)
(nënshkrimi) emri: _____

Dokumente të bashkëlidhura:

Shënim. Ju lutemi, bashkëlidhni kopje të vërtetuara të dokumenteve dhe dispozitave ligjore të referuara më sipër (në lidhje me ligjet e gjata ose Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, një kopje e dispozitave përkatëse do të ishte e mjaftueshme) dhe, gjithashtu, pajisni KfW-në me një përkthim zyrtar në anglisht ose gjermanisht të secilit prej dokumenteve të mësipërme, nëse ky dokument nuk është lëshuar në anglisht ose gjermanisht si një gjuhë zyrtare ose nëse KfW-ja nuk është shprehur se një gjuhë tjetër është e kënaqshme.

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 140 lekë